



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo



Opština Štrpce

Komuna e Shterpçes

Municipality of Strpce

REPUBLICA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTERPÇES

IZLAZNI - DALËSE

J. N. Prot. 01-020108-6023/20
Gr. Sh. 1
Dok. f. 1
Datum 30.06.2020.
Data 30.06.2020.

ŠTRPCE - SHTERPÇE

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shterpçes Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shterpçes në mbledhjen e mbajtur më datën 26/06/2020 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e jashtzakonshme e kuvendit e mbajtur me 20.06.2020

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS	
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPÇËS	
IZLAZNI - DALESH	
J. Brojt.	01-020 08-6023 20
Or. sht.	2
Nr. i lq.	
Datum	30. 06. 2020
Data	
ŠTRPCE - SHTËRPÇË	



Република Косово-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Општина Штрпце
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

PROCES VEBAL

Nga Kuvendi i jashtzakonshëm i Komunës së Shtërpçës mbajtur më 10.06.2019, me fillim
në ora 10:00 h.

Rendi i ditës:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i planit akcional për transparëncë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e planifikimit dhe aprovimit të buxhetit për 2021-2023
- Rishqyrtimi dh aprovimi i plotësimit dhe ndryshimit të Statutit të komunës së Shtërpçës.

Predrag Grbic: Sot marriimpjesë në seancën e parë të jashtzakonshme për vitin 2020, prezent janë të gjithë këshilltarët, kemi kuorum dhe seanca mund të filloj.

1.

Shqyrtimi dhe aprovimi i planit akcional për transparëncë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e planifikimit dhe aprovimit të buxhetit për 2021-2023

Predrag Grbic: Një pikë që është shumë e rëndësishme për komunën tonë është pjesëmarja e qytetarëve në hartimin e buxhetit, kështu që më 29 maj në Kuvendin që kemi mbajtur kemi pasur në rendin e ditës formimin e një grupei punues, disa ditë më vonë kemi mbajtur një mbledhje të atij grupei punues dhe disa ditë më vonë ne e kemi thirr një seancë të jashtezakonshme. Qëllimi ynë është t'i bëjmë ato gjëra shpejt, kur kemi mundësi, por jo t'i bëjmë ato me nxitim duke anashkaluar dispozitat ligjore, nuk është ashtu, gjithçka mbetet e njëjtë, përvèç se afati midis njërit dhe takimit tjetër është më i shkurtër. Ne mbajtëm një takim të grupit të punës, për fat të keq jo të gjithë zyrtarët ishin në gjendje të merrnin pjesë në atë grup pune, sepse komuna nuk funksionoi për disa muaj. Rezultati i këtyre bisedimeve është ky plan veprimi, i cili u prezantua për herë të parë në grupin e punës dhe tanë na është prezantuar neve. Unë mendoj se ata që ishin të pranishëm në atë grup pune mund të janë të kënaqur me diskutimin që kemi pasur, ka pasur një bisedë të mirë ku sqaruam disa dyshime për disa gjëra. Qëllimi ynë është të sjellim sa më shumë qytetarë në debate publike, sepse do të jetë shumë më e lehtë për ne si këshilltarë që të marrin vendime për atë që është përparësi për qytetarët tanë.

Radojka Repinovic: Muajin e kaluar, u formua një grup pune për të hartuar një plan veprimi për pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe miratimit të buxhetit. Grupi punues ka hartuar një plan veprimi dhe, siç shohim, aktivitetet e para janë tashmë në qershor. Qytetarët, organizatat joqeveritare dhe media janë të përfshirë në segmentin e tyre të veprimit tarisë, që është qëllimi që ky plan synon të arrijë. Plani i veprimit është shumë i kërkuar dhe kërkon një

angazhim të caktuar si nga përfaqësuesit e komunës së Shtërpës ashtu edhe nga qytetarët e komunës. Shpresoj që me miratimin e këtij plani të veprimit, ne do të kemi angazhimin maksimal të të gjitha palëve aktive.

Rifat Rustemi: Kam dy kërkesa në lidhje me planin e veprimit. Së pari, ajo që diskutuan në mbledhjen e grupit të punës lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve, që të kemi një numër më të madh të qytetarëve në debate publike sepse kemi pasur një numër të vogël, pothuajse nuk kemi pasur. Unë do të pyesja këshilltarët nëse munden dhe e di se munden, të aktivizojnë komunitetin, vendasit ku ata jetojnë për të ardhur dhe të marrin pjesë në debate publike. Sa i përket vendndodhjes së shkollës filllore ‘Razim Cokli’, ekzistojnë dy shkolla, për të ndryshuar vendndodhjen e takimit, për të mos mbajtur një debat publik siç ka qenë gjithmonë, por për të ndryshuar vendndodhjen, kështu që do të ketë pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve.

Predrag Grbic: Në plan është planifikuar të mbahet më 2 korrik në orën 10 në shkollën ‘Razim Cokli’ në fshatin Brod, po mendoni të jetë në fshatin Brod apo ndonjë lokacion tjetër, ju lutem na tregoni vetëm se në cilin vend është ta prezantoni në këtë plan që kemi dhe ta votojm atë ndryshim.

Rifat Rustemi: Është shkolla e njejtë por objekti është nr. 2

Danijel Vuksanovic: E di se përcilin objekt bëhet fjalë, do ta bëjmëashtu.

Predrag Grbic: Nuk lajmrohet askush përfjalë. E vë në votim këtë pikë.

Konstatoj se njëzërit e kemi aprovuar këtë pikë.

2.

Rishqyrtimi dh aprovimi i plotësimit dhe ndryshimit të Statutit të komunës së Shtërpës

Predrag Grbic: Këtu e kemi një gabim gjatë definimit të kësaj pike, por më shumë do t'ju sqaroj drejtori i administratës.

Havzi Ahmeti: Çdo akt i komunës kalon përmes një procesi verifikimi, pavarësisht nëse është i ligjshëm apo jo, të gjitha nga MAPL. Komuna e Shtërpës dërgoi një vendim në MAPL në mënyrë që ata të mund të vlerësojnë ligjshmërinë e këtij vendimi. Për shkak të pandemisë, ata shtynë vlerësimin e këtij vendimi. Ne morëm një e-mail ku thuhet se është konstatuar se kishte një gabim kur bëhet fjalë për ndryshimet në Statut, dhe ka të bëjë me terminologjinë e vendimeve. Ata sugjeruan që ta ndryshojmë përsëri, ta dërgojmë në Kuvend për rishqyrtim dhe pastaj t'ua përcjellim përsëri atyre. Kam biseduar në telefon me zyrtarët e MAPL-së, si ta bëj atë ndryshimin e këtij titulli, në mënyrë që të gjitha të janë në përputhje me ligjet në fuqi dhe udhëzimet administrative. Ne kemi bërë një ndryshim dhe po ju kërkojmë ta votoni, nuk ka asnjë ndryshim përvëç që nuk shkruan ‘vendim’. Dikur shkruhej që vendimi ishte miratuar, tanë nuk ka në titull vendim, por vetëm një ndryshim në Statut.

Predrag Grbic: Nuk lajmrohet askush përfjalë. E vë në votim këtë pikë.

Konstatoj se njëzërit e kemi aprovuar këtë pikë.

Seanca e sotme ka përfunduar, falëmnderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Staja Markovic



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtërpës

Predrag Grbic